

U D H Ë Z I M
Nr.15, datë 16.7.2003

**"PËR PROCEDURAT E HAPJES DHE MBYLLJES SË SALLAVE TË LOJËRAVE
ARITMETIKE, ELEKTRONIKE DHE PIKAVE TË LOJËRAVE TË FATIT
SPORTIVE"**

(Ndryshuar me udhëzimin nr. 2, datë 17.2.2004)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 102/4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, ligjit nr.8701, datë 1.12.2000 "Për lojërat e Fatit, Kazinotë dhe Hipodromet" dhe në zbatim të nenit 1 pika 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.238, datë 13.4.2001 "Për kriteret e dhënies së lejes për lojërat e fatit kazinotë dhe hipodromet" Ministri i Financave

U D H Ë Z O N:

1. Shoqëritë e lojërave të fatit për hapjen e sallave të reja të lojërave aritmetike dhe elektronike duhet të paraqesin në Drejtorinë e Lojërave të Fatit, kazinove dhe Hipodromeve pranë Ministrisë së Financave dokumentacionin e mëposhtëm:

a) *Njoftim* për hapjen e sallës dhe adresën e saktë të saj.

b) Të dhënat e mëposhtme për personelin e sallës:

1. Certifikatë personale të personelit

2. Vërtetim të gjendjes gjyqësore të personelit

3. Dëshmi kualifikimi të personelit

4. Kontratë pune të personelit.

c) Certifikimi nga Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë dhe Kalibrimit e teknologjisë përkatëse.

d) Garancinë për fituesin e lojës për automate ose sallë bingo.

e) Vërtetimin e pronësisë ose kontratën e qirasë për sallën e re.

f) Vërtetim pronësie, deklaratë zhdoganimi dhe certifikatë origjine për pajisjet.

g) Rregulloret përkatëse për lojërat që do të zhvillohen në këto salla.

h) Standardin e biletës për sallat e bingos.

2. Shoqëritë e lojërave të fatit, për hapjen e pikave të lojërave të fatit sportive duhet të paraqesin në Drejtorinë e Lojërave të Fatit, Kazinove dhe Hipodromeve pranë Ministrisë së Financave dokumentacionin e mëposhtëm:

a) *Njoftim* për hapjen e pikave dhe adresën e saktë të saj.

b) Akte blerjeje, fatura të tjera për teknologjinë përkatëse.

c) Vërtetim të gjendjes gjyqësore për personelin e pikës së lojërave të fatit sportive.

d) Kontratë pune të personelit të pikave të lojërave të fatit sportive.

e) Dëshmi kualifikimi për personelin e pikës së lojërave të fatit sportive.

f) Vërtetimin e pronësisë së pikave të lojërave të fatit sportive ose kontratën e qirasë.

3. Shoqëritë e lojërave të fatit për mbylljen e sallave të lojërave aritmetike, elektronike dhe të pikave të lojërave të fatit sportive duhet të paraqesin në Drejtorinë e Lojërave të Fatit, Kazinove dhe Hipodromeve pranë Ministrisë së Financave dokumentacionin e mëposhtëm:

a) *Njoftim* për mbylljen e sallës.

b) Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve tatimore për sallat e lojërave aritmetike, elektronike.

c) Zgjidhjen e kontratës për ambientet e marra me qira.

4. Brenda 3 mujorit të parë të vitit shoqëritë e lojërave të fatit duhet të paraqesin në

Drejtorinë e Lojërave të Fatit listën e personave që do të trajnohen për marrjen e dëshmime të kualifikimit në fushën e lojërave të fatit.

5. Shoqëritë e lojërave të fatit, për transferimin e automateve të miratuara nga sallat ekzistuese në salla të tjera duhet të paraqesin në Drejtorinë e Lojërave të Fatit, Kazinove dhe Hipodromeve pranë Ministrisë së Financave dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Kërkesë për transferimin e automateve.

b) Arsyet e transferimit të automateve.

6. *Shoqëritë e lojërave të fatit detyrohen të njoftojnë me të njëjtën shkresë Drejtorinë e Lojërave të Fatit, Kazinove dhe Hipodromeve, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, degën e tatim-taksave të rrethit përkatës, 15 ditë përpara hapjes së sallave, pikave të basteve sportive, për transferimin, shtimin dhe heqjen e automatëve elektronikë.*

7. *Verifikimi i hapjes së sallave, pikave të basteve sportive, si dhe transferimi, shtimi ose heqja e automatëve elektronikë kryhet nga ana e Policisë Tatimore. Akti i verifikimit do të dërgohet në Drejtorinë e Lojërave të Fatit, Kazinove dhe Hipodromeve brenda 15 ditëve nga data e deklaramit të tyre.*

"Në rast se shoqëritë e lojërave të fatit nuk paraqesin dokumentacionin e parashikuar në pikat 1, 2 dhe 3 të udhëzimit, nuk mund të ushtrojnë veprimtarinë pa e plotësuar këtë dokumentacion sipas kërkesave të këtij udhëzimi".

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
Kastriot Islami